



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 19/05/2022 Ref.: 657/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 99-të, të mbajtur më 13.05.2022, mori:

#### V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit UBT për periudhën tre vjeçare 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025.
  1. Stomatologji, Dr Dent, 360 ECTS, kampusi kryesor, maksimumi 25 studentë për vit akademik.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

#### A r s y e t i m i

Kolegji UBT kampusi kryesor, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për ri/akreditim të programeve të studimit. Bazuar në kërkesën e parashtruar, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Kolegjin UBT me qëllim të vlerësimit të programit të cekur në dispozitiv.


Për programin e studimit: Stomatologji, Dr Dent, 360 ECTS, në kampusin kryesor, Kolegji UBT si bartës të programit ka paraparë këta persona: Agim Prokshaj, Merita Barani, Ferjal Morina, Vjosa Hamiti, Visar Bunjaku, Xhevdet Aliu, Genc Demjaha dhe Sinan Rusinovci. Vlerësimi i programit është bërë nga ekspertët ndërkombëtar Joke Denekens, Adrian Tudor Stan dhe Marko Komso. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga 7 fushat e përgjithshme të përcaktuara në Manualin e Akreditimit ky program përmbushë plotësisht dy (2), substancialisht tri (3) dhe pjesërisht dy (2).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen 99 të mbajtur më 23.05.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit UBT kampusi kryesor, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit UBT, kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

